

**VENDIM**  
**Nr. 327, datë 14.12.2022**

**MBI MIRATIMIN E ÇMIMIT VJETOR TË BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE,  
QË DO T'U PAGUHEË PRODHUESVE EKZISTUES ME PËRPARËSI, PËR VITIN  
2023**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 10, të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM-së) nr. 687, datë 22.11.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit vjetor të blerjes të energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”, të ndryshuar; si dhe nenit 15, nenit 21 dhe nenit 22 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.12.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2061/4 prot., datë 12.12.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi miratimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi, për vitin 2023”,

konstatoi se:

- Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 687, datë 22.11.2017, ka miratuar “Metodologjinë e përcaktimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”, i rishikuar me VKM-në nr. 396, datë 13.5.2020, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 687, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”.

- Nga të dhënat paraprake nga faqja e internetit e Bursës Hungareze të Energjisë (<https://hupx.hu/en/market-data/dam/regular-reports>), është marrë çmimi i deritanishëm mesatar vjetor i tregut të ditës në avancë (HUPX/DAM) të energjisë elektrike në profilin bandë (*baseload*) për vitin 2022, i cili rezulton në vlerën 271.80 euro/mwh.

- Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, me normë mesatare të shkëmbimit të vitit të fundit, kuptohet kursi mesatar vjetor i këmbimit euro/lekë, i publikuar nga Banka e Shqipërisë për vitin 2022. Nga të dhënat e deritanishme të publikuara nga Banka e Shqipërisë mbi kursin e këmbimit, rezulton se kursi mesatar i këmbimit për 11 muajt, tashmë të mbyllur të vitit 2022 (janar–nëntor), rezulton të jetë 119.35 lekë/euro.

- Nga të dhënat paraprake rezulton se çmimi vjetor i blerjes do të jetë 38.93 lekë/kwh. Kufijtë minimalë dhe maksimalë të çmimit të blerjes së energjisë elektrike nga prodhuesit ekzistues me përparësi, përcaktohen sipas germave “ç” dhe “d”, të pikës 2, të VKM-së nr. 687, datë 22.11.2017, ku kufiri minimal është çmimi i miratuar nga ERE për vitin 2016 për këta prodhues (çmim dysHEME) dhe ai maksimal është 15% më i lartë se çmimi i miratuar nga ERE për vitin 2016 për këta prodhues (çmim tavan).

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 13 datë 16.2.2016, ka vendosur që, tarifa fikse e energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet për vitin 2016, do të jetë 7.448 lekë/kw.

- Çmimi maksimal i lejuar mbështetur në përcaktimet e VKM-së nr. 687, datë 22.11.2017, të ndryshuar, është 15% më i lartë se çmimi i miratuar nga ERE për vitin 2016 për këta prodhues:  $7.448 * (1 + 15\%) = 8.5652$  lekë/kwh.

- Çmimi i blerjes, i cili rezulton sipas të dhënave paraprake, për vitin 2023, është mbi kufirin maksimal (tavan), pra 15% më i lartë se çmimi i vendosur nga ERE për vitin 2016.

- Bazuar në publikimet e 11-mujorit të HUPX Dam Report, nuk parashikohen ndryshime të tilla në çmimin mesatar të Bursës Hungareze të tilla që të afektojnë në ulje të kufirit të sipërm të çmimit të blerjes së energjisë nga këta prodhues për vitin 2023.

- Lidhur me gjithë sa më sipër, çmimi vjetor i blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve me përparësi për vitin 2023, rezulton të jetë çmimi prej 8.5652 lekësh/kwh që përcaktohet në kufirin maksimal të VKM-së nr. 687, datë 22.11.2017. Ky çmim do të jetë objekt rishikimi nga ERE, në rast të ndryshimit të elementeve përbërëse të tij.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Miratimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi prej 8.5652 lekësh/kwh vitin 2023.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR**  
**Petrit Ahmeti**